

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6915
E mërkurë, 7 qershor 2023
Çmimi 0.40

Në vitin 2100 Kosova
do të jetë e dyta në
Ballkan me popullsinë
më të vjetër | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

EMISARËT GABRIEL ESCOBAR DHE MIROSLAV LAJÇAK KANË PARASHTRUAR
TRI KËRKESA PËR ALBIN KURTIN NË RAPORT ME SITUATËN NË VERI, OPOZITA
I KA BËRË THIRRJE QEVERISË TË KOORDINOHE T ME ALEATËT | FAQE 3

ESCOBARI I JEP DY DITË AFAT KURTIT

- Escobari thotë se Uashingtoni qëndron me popullin e Kosovës, por nuk mbështet një individ "që nuk ka instinkt bashkëpunimi"



I dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, kanë vazhduar takimet të hënën dhe të martën me liderët politikë në Kosovë, të pozitës dhe opozitës. Qetësimi i situatës në

veri të Kosovës, mbajtja e zgjedhjeve të reja dhe kthimi në dialog, ishin tri kërkesat e Escobarit dhe Lajçakut për kryeministrin Albin Kurti. Emisari amerikan i ka dhënë dy ditë afat kryeministrit Kurti që të pajtohet me kërkesat e ShBA-së dhe të BE-së për situatën

në veri meqë të premtën ai dhe emisari Lajçak do t'u raportojnë eprorëve të tyre nëse ka sukses ose jo. Ai ka thënë se Uashingtoni qëndron me popullin e Kosovës, por ka theksuar se Uashingtoni nuk mbështet një individ "që nuk ka instinkt bashkëpunimi"

MË 10 QERSHOR
SHOQËRIA "LËVIZJA"
VENDOS PLLAKË
PËRKUJTIMORE NË
SHTËPINË E ATDHETARIT
SHASIVAR MAKOLLI | FAQE 4-5



ÇFARË I
NDODHI
DIGËS
KAHOVKA
NË
UKRAINË?
| FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



INFANTINO URON BALLKANIN PËR
TITULLIN E KAMPIONIT | F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Dhjetëra të vdekur nga përmbytjet në Haiti

LEOGANE, 6 QERSHOR - Të paktën 42 persona kanë mbetur të vdekur në Haiti pash reshjeve të dendura të shiut që shkaktuan përmbytje gjatë fundjavës, thanë autoritetet e emergjencës të Haitit. Njëmbëdhjetë të tjerë raportohet se janë ende të zhdukur dhe mbi 13 000 janë detyruar të zhvendosen nga shtëpitë e tyre të dëmtuara nga vërshimet. Qyteti i goditur më së rëndi është Leogane, në jug-perëndim të kryeqytetit Port-au-Prince, ku tre lumenj kanë dalë nga shtretërit. Në përgjithësi, gjysma e zonave në vendin e varfër të Karaibeve është prekur nga këto vërshimet. Vendasja Phania Cange e humbi shtëpinë e saj, e cila u rrëmbye nga vërshimet. Ajo arriti ta shpëtojë njërin nga fëmijët e saj, por fëmija tjetër i saj, tre vjeç, vdiq

nga përmbytjet. “Rrezikova t’i humbisja dy fëmijët, por Zoti ma la tjetrin të varur për një pemë”, tha Cange. Kryetari i zonës së Leogane, Erson Henry, tha se banorët e qytetit ishin “të dëshpëruar”. “Ata kanë humbur gjithçka. Ujërat ua kanë shkatërruar fushat, ua kanë shpërndarë kafshët shtëpiake”, tha ai për agjencinë e lajmeve, AFP. Raportohet se numri i të vdekurve mund të rritet. Kryeministri Ariel Henry tha se qeveria e tij, bashkë me partnerët ndërkombëtarë, po “merre masa urgjente” për ta luftuar këtë katastrofë. Programi Botëror i Ushqimit (WFP) tha se do të fillonte t’i furnizonte të gjithë njerëzit e zhvendosur me racione të



ushqimit të nxehtë. Infrastruktura e vendit është dëmtuar nga tërmetet e shumta

të mëdha. Operacionet e shpëtimit vështirësohen nga problemet e vazhdueshme të

Haitit me bandat kriminale, që kontrollojnë shumë zona të vendit.

Mes tensioneve me ShBA-në, Irani prezanton raketë të re

TEHRAN, 6 QERSHOR - Irani pretendoi më 5 qershor se e ka krijuar një raketë hipersonike të aftë për t’i mposhtur mbrojtjet ajrore dhe që udhëton me shpejtësi 15 herë më të madhe se shpejtësia e zërit. Prezantimi i kësaj rakete vjen në një kohë tensionesh me ShBA-në. Raketa e re, e quajtur Fattah, ose “pushtuesi” në gjuhën shqipe u prezantua në të njëjtën ditë kur Irani tha se do t’i rihapte zyrat diplomatike në Arabinë Saudite, pasa disa viteve konflikt me Riadin zyrtar.



Segmenti i publikuar në televizionin shtetëror iranian raportohet se synonte të tregonte se qeveria e Teheranit


mund të përdorë armë kundër armiqve të saj në pjesën më të madhe të Lindjes së Mesme. “Sot ne ndjejmë se është formuar fuqi parandaluese”, tha presidenti iranian, Ebrahim Raisi, gjatë eventit. “Kjo fuqi është një garanci e sigurisë dhe paqes së qëndrueshme për vendet e rajonit”. Gjenerali Amir Ali Hajizadeh, kreu i programit të hapësirës ajrore të Gardës Revolucionare paraushtarake, e prezantoi atë që dukej të ishte një model i kësaj rakete. Hajizadeh

pretendoi se raketa kishte një rreze veprimi deri në 1,400 kilometra. Kjo nënkupton se kjo raketë i takon gamës së mesme të arsenalit të raketave balistike të Iranit, të cilin Irani e ka ndërtuar gjatë viteve pasi sanksionet perëndimore kryesisht e pengojnë atë të ketë qasje në armatim të avancuar. Prezantimi i raketës së Iranit erdhi pasi sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, do ta nisë një vizitë në Arabinë Saudite.

Gjykata evropiane dënon Rusinë lidhur me helmimin e Navalnyt

STRASBOURG, 6 QERSHOR - Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (ECHR) e dënoi Rusinë më 6 qershor për dështimin në hetimin e duhur të helmimit të opozitarit Alexei Navalny në vitin 2020, për të cilin Perëndimi thotë se ishte një tentim për vrasje. ECHR-ja, me seli në Strasburg të Francës, tha se Rusia kishte dështuar në mënyrë të dukshme “t’i hetojë pretendimet për një motiv të mundshëm politik për tentativën e vrasjes, si dhe përfshirjen e mundshme të agjentëve shtetërorë”, duke konstatuar unanimisht se Rusia e kishte shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në deklaratën e publikuar thuhet se Rusia kishte refuzuar të hapte procedurë penale për helmimin që kishte bërë që Navalny të binte në komë. Aktivisti opozitar kundër korrupsionit, i parë nga

mbështetësit e tij si një rival i mundshëm politik i presidentit të Rusisë, Vladimir Putin, u sëmur gjatë një fluturimi nga Siberia. Ai më vonë u evakuua në Gjermani, ku u shërua, por u burgos menjëherë pas kthimit të tij në Moskë dhe që atëherë ka qenë në burg. ECHR-ja vuri në dukje se testet e kryera nga qeveria gjermane kishin gjetur “prova të qarta” të pranisë së helmit kimik Novichok në trupin e Navalnyt. Gjykata evropiane tha se hetimi i bërë nga Rusia lidhur me këtë rast nuk ishte i hapur dhe se Navalny nuk ishte lejuar të merrte pjesë. Hetimi nuk arriti “të çonte në vërtetimin e fakteve përkatëse, si dhe identifikimin dhe, nëse do të ishte e përshtatshme, ndëshkimin e personave përgjegjës”, tha ai. “Prandaj (hetimi) nuk mund të konsiderohet adekuate”.



Rusia u urdhërua ta paguante Navalnyn 40.000 euro si dëmshpërblim. ECHR-ja është pjesë e organit të të drejtave pan-evropiane, Këshilli i Evropës, nga ku Rusia u përjashtua pas pushtimit të

paprovokuar të Ukrainës vitin e kaluar. Megjithatë, ECHR-ja tha se ka ende një numër të madh të rasteve të paraqitura nga shtetas rusë para përjashtimit të Rusisë dhe bëri të ditur se do të vazhdojë

hetime dhe të nxjerrë vendime për ato raste. Kjo gjykatë thotë se Rusia është ligjërisht e detyruar t’i zbatojë vendimet e ECHR-së në lidhje për rastet e nisura deri më 16 shtator 2022.

Çfarë i ndodhi digës Kahovka në Ukrainë?



Ukraina e ka akuzuar Moskën për hedhjen në erë të një dige të madhe në lumin Dnjepër, që kalon nëpër rajonin Herson, të pushtuar nga Rusia. Të kërcënuar nga përmbajtjet masive, dhjetëra mijëra njerëz në rrjedhën e poshtme të digës Nova Kahovka u urdhëruan të evakohen

KIEV, 6 QERSHOR - Një digë e madhe, e periudhës sovjetike, në lumin Dnjepër, është shkatërruar të martën, duke vërshuar një pjesë të konsiderueshme të territorit. Diga i ndan forcat ruse dhe ato ukrainase në jug të Ukrainës. Ukraina ka thënë se Rusia e ka shkatërruar atë, ndërsa zyrtarët rusë kanë bërë deklarata kundërtënëse - disa kanë thënë se ajo është shkatërruar nga bombardimet ukrainase, të tjerë kanë thënë se është shkatërruar për shkak të një dëmi paraprak. Diga Kahovka, me lartësi prej 30 metrash dhe gjerësi prej 3.2 kilometrash, është ndërtuar më 1956 në lumin Dnjepër, në kuadër të hidrocentralit Kahovka.

Ky rezervuar e furnizon me ujë Gadishullin ukrainas të Krimesë, të cilin e ka aneksuar Rusia më 2014, si dhe centralin bërthamor në Zaporizhja, i cili, po ashtu, është nën kontrollin rus. Rezervuari ka ujë në sasi prej 13 kilometrash kub - sasi e përafërt me Liqenin e Madh të Njelmët në shtetin amerikan Utah.

Çfarë ka ndodhur?

Ukraina, e cila e ka komentuar e para situatën, ka thënë se Rusia është përgjegjëse. "Terroristët rusë. Shkatërrimi i hidrocentralit në Kahovka vetëm ia konfirmon gjithë botës që ata duhet të dëbohen nga secili cep i tokës ukrainase", ka thënë presidenti ukrainas

Volodymyr Zelensky në aplikacionin për mesazhe "Telegram". "Rezervuari në Kahovka është hedhur në erë nga forcat pushtuese ruse", ka thënë komanda jugore e ushtrisë ukrainase.

Shkalla e shkatërrimit, shpejtësia dhe dëmet janë duke u vlerësuar.

Disa zyrtarë të instaluar nga Rusia e kanë fajësuar Ukrainën. Administrata e Hersonit, e instaluar nga Rusia, ka thënë se Ukraina e ka bombarduar digën rreth orës 23:00, duke ia dëmtuar valvulet hidraulike. "Të martën, më 6 qershor, forcat e armatosura ukrainase e kanë goditur digën e hidrocentralit Kahovski dhe, si rezultat, është dëmtuar pjesa e sipërme e strukturës hidraulike", është thënë në deklaratë.

Të tjerë zyrtarë të instaluar nga Rusia kanë thënë se nuk ka ndodhur asnjë sulm.

Vladimir Rogov, zyrtar rus i instaluar në Zaporizhja, ka thënë se diga është shembur për shkak të një dëmi paraprak si dhe

presionit të ujit.

Agjencia shtetërore e lajmeve në Rusi, TASS, ka raportuar ngjashëm.

Ndikimi te banorët

Teksa nivelet e ujit sa shkojnë e rriten, disa mijëra njerëz besohet se do të përballen me situatën. Evakuimet e civilëve nga të dyja anët veçse kanë nisur.

Besohet se 22 000 njerëz që jetojnë në 14 vendbanime në rajonin e Hersonit, në jug të Ukrainës, rrezikojnë të përballen me vërshime, kanë thënë zyrtarë të instaluar rusë. Ata u kanë thënë njerëzve që të bëhen gati për evakuim.

Kryeministri ukrainas Denys Shmyhal ka thënë se 80 vendbanime rrezikojnë të vërshohen.

Gubernatori i përkrahur nga Rusia në Krime ka thënë të martën se ekziston rreziku që nivelet e ujit në Kanalin Verior të Krimesë - i cili e dërgon ujin në gadishull, përmes lumit Dnjepër - mund të rriten edhe më shumë

pas shembjes së digës.

Gadishulli i Krimesë është i varur prej këtij uji.

Ukraina paraprakisht i ka bllokuar furnizimet me ujë të pijshëm në Krime, pasi Rusia e ka aneksuar gadishullin më 2014, duke rezultuar me mungesë uji në rajon.

Centrali bërthamor

Centrali bërthamor në Zaporizhja - më i madhi në Evropë - e merr ujin e ftohtë nga rezervuari.

Ai gjendet në anën jugore, që tani është nën kontrollin rus.

Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Çështje Bërthamore ka thënë në "Twitter" se është duke e vëzhguar situatën nga afër, por nuk ekziston "rrezik i menjëhershëm i sigurisë në central".

Agjencia shtetërore ruse për çështje bërthamore, Rosatom, ka thënë të martën se nuk ekziston asnjë rrezik për centralin bërthamor të kontrolluar nga Moska.

Shefi i NATO-s: Rusia s'mund ta bllokojë anëtarësimin e Ukrainës

BRUKSEL, 6 QERSHOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se Rusia nuk mund ta ndalojë anëtarësimin eventual të Ukrainës në aleancën perëndimore të mbrojtjes ushtarake. "Të gjithë aleatët pajtohen se dera e NATO-s mbetet e hapur, që Ukraina do të bëhet anëtare e aleancës dhe se Rusia nuk ka të drejtë vetoje", tha Stoltenbergu më 6 qershor. Deklarata e Stoltenbergut

erdhi gjatë vizitës së tij në kryeqytetin e Sllovakisë, në Bratislavë, për bisedime me presidentët e vendeve anëtare të aleancës në kufirin e saj lindor, të ashtuquajturin grupi i Nëntë i Bukureshtit. Nisja e pushtimit të përvokuar të Ukrainës nga Rusia në shkurt të vitit të kaluar e ka shtuar aktivitetin e NATO-s, aleancës së themeluar pothuajse 75 vjet më parë, për ta kundërshtuar Bashkimin Sovjetik. Bisedimet në Bratislavë vijonë

pak para samitit të ardhshëm të NATO-s në Vilnius, ku Stoltenbergu tha se aleanca veri-atlantike do të marrë vendime "shumë të rëndësishme". "Ne do ta përforcojmë mbështetjen tonë për Ukrainën me një pako shumëvjeçare të ndihmave për t'u ndihmuar të kalojnë nga standardet e epokës sovjetike në standardet e NATO-s dhe ta sjellim Ukrainën më afër NATO-s", tha ai.





EMISARËT GABRIEL ESCOBAR DHE MIROSLAV LAJÇAK KANË PARASHTRUAR TRI KËRKESA PËR ALBIN KURTIN NË RAPORT ME SITUATËN NË VERI, OPOZITA I KA BËRË THIRRJE QEVERISË TË KOORDINOHET ME ALEATËT

Escobari i jep dy ditë afat Kurtit

- Escobari thotë se Uashingtoni qëndron me popullin e Kosovës, por nuk mbështet një individ “që nuk ka instinkt bashkëpunimi”

I dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, kanë vazhduar takimet të hënën dhe të martën me liderët politikë në Kosovë, të pozitës dhe opozitës. Qetësimi i situatës në veri të Kosovës, mbajtja e zgjedhjeve të reja dhe kthimi në dialog, ishin tri kërkesat e Escobarit dhe Lajçakut për kryeministrin Albin Kurti. Emisari amerikan i ka dhënë dy ditë afat kryeministrit Kurti që të pajtohet me kërkesat e ShBA-së dhe të BE-së për situatën në veri me qëllim të premtën ai dhe emisari Lajçak do t’u raportojnë eprorëve të tyre nëse ka sukses ose jo. Ai ka thënë se Uashingtoni qëndron me popullin e Kosovës, por ka theksuar se Uashingtoni nuk mbështet një individ “që nuk ka instinkt bashkëpunimi”

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Qetësimi i situatës në veri të Kosovës, mbajtja e zgjedhjeve të reja dhe kthimi në dialog ishin tri kërkesat e të dërguarit të Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Mirosllav Lajçak, dhe të dërguarit amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobarit, gjatë takimit me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, në Prishtinë. “Ne e

prezantuam një propozim në emër të komunitetit ndërkombëtar që përmban tri elemente. Kishim bisedime të gjata, të singerta dhe të vështira”, ka thënë Lajçaku pas takimit trepalësh mbrëmjen e 5 qershorit. Ai ka thënë se është në interes të të gjithëve që në veri të Kosovës të ketë kryetarë “legjitimë” të komunave dhe që i përfaqësojnë qytetarët.

Escobaru ka thënë se ai erdhi në këtë takim, i cili zgjati mbi dy orë, si mik i Kosovës dhe tha se shpreson që kërkesat e tyre të

dëgohen. “Nuk kam parë kurrë kaq shumë unitet brenda komunitetit transatlantik. ShBA-ja, BE-ja, NATO-ja dhe pothuajse çdo mik i Kosovës e ka bërë të njëjtin propozim. Kështu që shpresoj të dëgjohemi”, ka deklaruar Escobari.

Të pyetur se a i ka pranuar Kurti propozimet e tyre, të dy thanë se janë në “fillim të misionit të tyre”, që do të zgjasë dy ditë. “Shpresoj se do të njoftojmë për lajme të mira në fund, por nuk kemi arritur ende atje”, ka theksuar Lajçaku.

I dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, pas takimeve me përfaqësuesit e pushtetit dhe të opozitës, ka mbajtur një takim me gazetarë në Ambasadën Amerikane në Prishtinë.

Emisari amerikan i ka dhënë dy ditë afat kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, që të pajtohet me kërkesat e ShBA-së dhe të BE-së për situatën në veri me qëllim të premtën ai dhe emisari Lajçak do t’u raportojnë eprorëve të tyre nëse ka sukses ose jo. “E para është deeskalimi, e dyta është duam të shohim zgjedhje të reja me pjesëmarrjen e serbëve, e treta duhet menjëherë të lëvizim drejt zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit që nënkupton se duhet të shohim përpjekje reale nga Kosova që të angazhohet për Asociacionin dhe, po ashtu, duhet të shohim hapa nga Serbia. Duhet të merremi vesh për këtë sot dhe nesër, sepse të premtën unë dhe Lajçaku duhet t’u raportojmë eprorëve tanë se a ishim të suksesshëm apo jo”, ka thënë Escobari.

Ai ka thënë se Uashingtoni qëndron me popullin e Kosovës, por theksoi se Uashingtoni nuk mbështet një individ “që nuk ka instinkt bashkëpunimi”. “Ne po e shohim që po merren vendime pavarësisht partneritetit tonë dhe ky është sinjal për ne. Ne nuk mund të pranojmë këtë gjë. Prandaj, në një pikë, kur të duam ta rikthejmë koordinimin dhe partneritetin me këtë qeveri, ne jemi të gatshëm, sepse ne gjithmonë do të jemi me popullin e Kosovës. Kjo nuk nënkupton që duhet ta mbështetim një individ që nuk ka atë instinkt të bashkëpunimit”, ka deklaruar ai. Escobari shtoi se “ne jemi plotësisht konfuzë” me atë që është duke ndodhur.

I pyetur nëse raportet në mes të Qeverisë së Kosovës dhe ShBA-së janë dëmtuar, Escobari tha “nuk është vetëm ShBA-ja, është i tërë komuniteti transatlantik”. “Pra, nuk jemi vetëm ne, nuk janë vetëm 27 shtetet e BE-së, dhe ShBA-ja e Mbretëria e Bashkuar. Ne i shohim gjërat njësoj, ne jemi mbështetës. Po

vjen prej diku tjetër. Dhe, po, mund të ketë një ndikim afatgjatë”, theksoi ai.

Escobari tha se ShBA-ja është e përkushtuar për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, sigurinë dhe prosperitetin ekonomik. “Do të jem shumë i sinqertë, ShBA-ja ka qenë mbështetësja juaj më e madhe dhe më dhemb të shoh që njerëzit mendojnë se disi ne po e drejtojmë raportin dhe angazhimin tonë me Kosovën për përfitim të Serbisë”, ka pohuar Escobari.

Kurti fton Brukselin dhe Uashingtonin të bëjnë thirrje për ndalim të dhunës në veri

Qeveria e Kosovës ka lëshuar një komunikatë pas këtij takimi, në të cilën ka bërë me dije se u shkëmbyen mendime mbi gjendjen dhe zhvillimet e fundit, ide për deeskalim të situatës në veri dhe urgjenca për zbatim të Marrëveshjes Bazike e Aneksit të zbatimit. Kryeministri ka thënë se rruga përpara është ndalimi i menjëhershëm i sulmeve nga ekstremistë të dhunshëm dhe grupe kriminale ndaj organeve të sigurisë vendore dhe ndërkombëtare si dhe gazetareve.

Ai i ka ftuar Brukselin dhe Uashingtonin të bëjnë thirrje për ndalim të dhunës dhe ndjekje penale e ndëshkim të kryerësve të saj. “E tillë duhet të jetë edhe fushata parazgjedhore”, theksoi kryeministri Kurti. Ai tha se kandidatët dhe votuesit në zgjedhjet e reja duhet të garojnë e marrin pjesë pa frikë e kërcënime. “Rendi dhe ligjshmëria sigurisht do ta zvogëlonin proporcionalisht edhe numrin e policëve në ndërtesat komunale në tri komunat veriore. Kryeministri Kurti shprehu gatishmërinë e pazezërë dhe mirëbesimin e palëkundur për angazhim intensiv e të përbashkët për deeskalim të gjendjes dhe normalizim të marrëdhënieve”, bëhet me dije në njoftimin e

Qeverisë së Kosovës. Sipas këtij njoftimi të qeverisë, vetëm sundimi i ligjit mund t’u hapë rrugë zgjedhjeve të parakohshme, të lira, demokratike dhe të ndershme.

Osmani në takim me Escobarin dhe Lajçakun: Zgjedhjet e reja në komunat në veri të vendit mund të organizohen

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur sot në takim përfaqësuesin special të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe përfaqësuesin special të BE-së për Dialog, Miroslav Lajçak. Në takim, presidentja Osmani ka shprehur përkushtimin e plotë që të punohet së bashku me partnerët ndërkombëtarë në mënyrë që në veri të vendit të sundojnë rendi dhe ligji dhe të ruhet sovraniteti i Republikës së Kosovës. Sipas Osmanit, ndëshkimi i grupeve kriminale dhe individëve që përdorin dhunë ndaj policisë, gazetareve, pjesëtarëve të KFOR-it, EULEX-it dhe qytetarëve, është rruga e vetme për stabilitet të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Prandaj, theksoi ajo, presim që institucionet ligjzbatuese ta bëjnë punën e tyre, në përputhje me ligjin, në mënyrë që grupet kriminale përgjegjëse për dhunën të përballen me drejtësinë.

Osmani ka potencuar se zgjedhjet e reja në komunat në veri të vendit mund të organizohen në përputhje me kornizën aktuale kushtetuese e ligjore dhe, në këtë kontekst, ajo shtoi se duhet të sigurohet pjesëmarrje demokratike e qytetarëve që jetojnë në këto katër komuna.

Në takim me të dy emisarët, presidentja Osmani potencoi rëndësinë e fuqizimit të aleancës me ShBA-në dhe BE-në për përmbushjen e synimeve të përbashkëta për



rrugën euroatlantike dhe fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës.

Escobari dhe Lajçaku takojnë edhe liderët e opozitës

Escobari dhe Lajçaku janë takuar edhe me liderët e opozitës. Këta të fundit kanë kërkuar nga qeveria që të koordinohet me aleatët.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se asnjëherë nuk i ka parë më të shqetësuar dhe të zhgënjyer partnerët ndërkombëtarë sesa tani. Ai pas takimit me të dërguarin e posaçëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe atë të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë se nga ta janë informuar për gjendjen dhe kërkesat në raport me institucionet e Kosovës. Sipas tij, nuk ishte e lehtë që nga partnerët strategjikë të Kosovës të dëgjohej ankesa karshi veprimeve të institucioneve të Kosovës.

Krasniqi ka thënë se PDK-ja do të vazhdojë të ketë konsultime

ditore me të gjitha personat përgjegjës edhe për mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të reja në atë pjesë.

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, i cili takoi Escobarin dhe Lajçakun, ka thënë se vendi në futet në një situatë shqetësuese dhe tepër të paqartë për shkak të veprimeve të pamatura të kryeministrit Kurti. Sipas tij, shqetësuese është edhe mosgatishmëria e Kurtit që të koordinohet me aleatët ndërkombëtarë. Ai ka thënë se Kosova mund të ketë edhe pasoja të tjera nga ShBA-ja, BE-ja dhe NATO-ja.

Më tutje, Abdixhiku ka thënë se shpreson se Kurti të reflektojë, ndërsa i ka bërë thirrje presidentes Vjosa Osmani të jetë “më e qartë dhe më e zëshme në këtë moment kritik për Kosovën”. “Po futemi në një situatë bukur shqetësuese për Republikën e Kosovës dhe, për më tepër, të paqartë. Shqetësuese për shkak të gjendjes së relacioneve që Kosova i ka me aleatët e saj dhe të paqartë për shkak të mungesës së planit dhe gatishmërisë së kryeministrit të Kosovës për pajtim me aleatët

tanë”, ka thënë Abdixhiku.

Ai ka theksuar se në këtë fazë qytetarëve u mbetet t’i shohin pasojat që mund të vijnë nga një relacion i tillë, në radhë të parë nga ShBA-ja, BE-ja dhe NATO-ja. “Një gjendje të tillë si LDK e kemi të vështirë ta pranojmë. Si parti politike opozitare me numër të kufizuar të deputetëve në Kuvend, veprimet tona do të jenë publike, në të njëjtën kohë shpresojmë se mediet ta transmetojnë sa më qartë gjendjen e Kosovës sot. Qytetarët ta kuptojnë përtej populizmit, për rrugën që kryeministri Kurti po e fut Kosovën”, ka thënë Abdixhiku. Serbët lokalë edhe të martën i kanë vazhduar protestat në tri komunat në veri të Kosovës, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Ata po protestojnë rregullisht prej 29 majit, për ta kundërshtuar hyrjen e kryetarëve shqiptarë në ndërtesat komunale.

Faktori ndërkombëtar ka bërë thirrje të vazhdueshme për uljen e tensioneve tensioneve dhe, së fundi, disa kanë kërkuar mbajtjen e zgjedhjeve të reja në veri. Zyrtarët të lartë të Kosovës kanë dhënë shenja se mund të ndodhë diçka e tillë.

Zëvendësministri i MPB-së: Po punojmë që ta zvogëlojmë numrin e armëve të paligjshme

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Ministria e Punëve të Brendshme ka mbajtur takimin e 9-të lokal koordinues për udhërrëfyesin për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta dhe municioneve (AVL).

Takimin e hapi koordinatori kombëtar për AVL-të, njëherësh zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Blerim Gashani, i cili fillimisht i falënderoi për pjesëmarrje të pranishmit në takimin e 9-të me radhë lokal koordinues, të organizuar nga Ministria e Punëve të

Brendshme.

Në hapje të takimit zëvendësministri Gashani vuri në dukje se gjatë periudhës raportuese korrik-dhjetor 2022 kapacitetet në fushën e kontrollit kufitar, mbikëqyrjes së vijës së gjelbër kufitare, analizës së përbashkët të riskut, përmirësimit i hetimeve të trafikimit të armëve dhe kriminalitetit me armë dhe aspekti teknologjik janë rritur me asistencën e organizatave ndërkombëtare dhe përkrahjen e fuqishme financiare të donatorëve në kuadër të implementimit të projekteve të paraqitura në kuadër të



zbatimit të Udhërrëfyesit rajonal për AVL.


“Unë jam i sigurt që mbështetja dhe përkrahja juaj me mjete

financiare, profesionistë dhe ekspertë, do të vazhdojë edhe për Udhërrëfyesin për Armë të Vogla dhe të Lehta, ku do të

zbatohet dhe do të jetë i suksesshëm në mënyrë që të kontribuojmë dhe ta zvogëlojmë numrin e armëve në posedim të paligjshëm si dhe keqpërdorimin e tyre”, ka thënë zëvendësministri Gashani.

Ai ka theksuar se krahas të arriturave në fushën e zbatimit të udhërrëfyesit rajonal, gjithmonë ekziston rreziku nga metodat e vjetra të trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe eksplozivëve që janë evidente, por që tashmë po shohin një avancim të modus operandit nga trafikantët e AVL-ve, si dhe në aspektin e prodhimit të armëve, konvertimit.

QKMF në Podujevë fillon shërbimin shtëpiak për pacientët pa përkujdesje familjare



PODUJEVË, 6 QERSHOR - Nga muaji prill Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Podujevë ka filluar shërbimin geriatrik (personat pa përkujdesje familjare), shërbimet që u ofrohen pacientëve përfshin komponentin fizik, social dhe

psikik të shëndetit. Kontrollat mjekësore ofrohen nga stafi shëndetësor në shtëpitë e pacientëve. Ky shërbim po ofrohet në vazhden e avancimit të shërbimit të kujdesit mjekësor shtëpiak për pacientët në nevojë. Numri i telefonit pa pagesë

080019111 çdo ditë pune dhe vikendeve në orarin 08-19. "Ftohen qytetarë që njohin persona pa përkujdesje familjare dhe kanë nevojë për marrjen e shërbimeve mjekësore t'i paraqesin rastet në këtë numër", ka njoftuar komuna e Podujevës.

Totaj pret në takim zyrtarët e USAID-it, diskutohet për të drejtat pronësore

PRIZRENIT, 6 QERSHOR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur në takim zyrtarët e aktivitetit të USAID-it "Qeverisja e Pronës" - një aktivitet pesëvjeçar që synon ta përmirësojë sistemin e të drejtave pronësore në Kosovë për ta rritur fuqizimin e grave dhe për t'i përmirësuar të drejtat

formale të pronës si dhe investimet në pronën e paluajtshme. Ky aktivitet ka rëndësi të veçantë, pasi do të ndihmojë në mobilizimin e pjesëmarrjes së qytetarëve për t'i përmirësuar proceset e të drejtave pronësore dhe ofrimin e shërbimeve.



Lladrovci takon drejtuesit e 'Ibër-Lepencit', flasin për ujitjen e tokave bujqësore

DRENAS, 6 QERSHOR - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me shefin e kabinetit, Skender Berisha dhe drejtoreshën e Bujqësisë, Anita Avdullahu, kanë pritur në takim drejtorin e "Ibër-Lepencit", Faruk Mujka, me bashkëpunëtorë, me ç'rast kanë diskutuar për bashkëpunimin e deritashëm dhe për përkrahjen e kësaj kompanie për bujqit në ujitjen e tokave bujqësore. "Rëndësia e ujit për bujqësinë në përgjithësi për komunën e Drenasit është shumë e madhe. Edhe pse nuk kemi buxhet të mjaftueshëm, do të përpiqemi maksimalisht, me përkrahjen e



'Ibër-Lepencit', të sigurojmë ujin për fushat dhe fermat e komunës sonë", ka thënë kryetari Lladrovci. Ai e ka falënderuar drejtorin Mujka për bashkëpunimin e deritashëm dhe ka kërkuar që edhe më tej të ketë përkrahje për ujitjen e sipërfaqeve të tokave bujqësore të komunës së Drenasit, duke u përpjekur të sigurohen fonde të përbashkëta për këtë qëllim.



Më 10 qershor Shoqëria "Lëvizja" vendos pllakë përkujtimore në shtëpinë e atdhetarit Shasivar Makolli

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Më 10 qershor, në 125-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe në 24-vjetorin e nënshkrimit të kapitullimit të Serbisë, Shoqëria Lëvizja do të vendosë pllakë përkujtimore në shtëpinë e atdhetarit të shquar

të çështjes kombëtare, Shasivar Makolli. "Manifestimi në nder të këtij luftëtari të lirisë, shtëpia e të cilit u shndërrua në një bazë të fuqishme të luftës çlirimtare, do të fillojë me vendosjen e luleve te varri i tij, në varrezat e qytetit në Prishtinë, të shtunën

më 10 qershor 2023, në orën 12:30. Pas kësaj ceremoni kortezhi do të nisët për te shtëpia e familjes Makolli në Kodrën e Trimave, ku në orën 13:00 do të shpalojë pllaka përkujtimore", thuhet në njoftimin e Shoqërisë "Lëvizja".

Ndahen 149 motokultivatorë dhe pesë plugje për bujqit e Rahovecit

RAHOVEC, 6 QERSHOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se përkushtimi dhe interesimi i përhershëm i qeverisë lokale për të vënë në krye të agjendës zhvillimore bujqun rahovecas, u dëshmuua edhe me shpërndarjen e 149 motokultivatorëve dhe pesë plugjeve për bujqit. "Bashkë me drejtorin e Drejtorisë për Bujqësi,

Berat Duraku, si dhe bashkëpunëtorë të tjerë, kemi vazhduar procesin e shpërndarjes së mekanizmit bujqësor për 154 përfitues në projektin: 'Furnizim me mekanizëm bujqësor'. Pajisjet bujqësore të cilat janë shpërndarë sot janë 149 motokultivatorë dhe pesë plugje pesëkrahëshe. Komuna e Rahovecit do të vazhdojë ta trajtojë me dinjitet bujqun

rahovecas me të vetmin qëllim: ndihmën e vazhdueshme për të, me mekanizëm për bujqit, e që ndikon drejtpërdrejt në lehtësimin e punës së tyre, rrjedhimisht në rritjen e ekonomisë lokale", ka thënë Latifi. Ai ka theksuar se së shpejti do të shpërndahet edhe pjesa tjetër e përfituesve të motokultivatorëve si dhe pajisje të tjera për bujqit.



Në vitin 2100 Kosova do të jetë e dyta në Ballkan me popullsinë më të vjetër

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Kombet e Bashkuara parashikojnë që deri në vitin 2100 çdo i katërti banor i planetit do të jetë mbi 65 vjeç. Sipas parashikimit, popullsia e vendeve të Ballkanit Perëndimor do të jetë kryesisht më e moshuar dhe në këtë botë do të prijë Shqipëria, ndërsa

Kosova në vendin e dytë. Shqipëria e para me 49.1 për qind, e pastaj Kosova do të radhitet e dyta me 43.7 për qind. Në vendin e tretë popullsinë më të vjetër do ta ketë Serbia me 37.5 për qind, pastaj Maqedonia e Veriut me 36.6 për qind, Bosnja e

Hercegovina me 36.4 për qind dhe Mali i Zi 34.2 për qind. Në vitin 2022 Katari ishte vendi me më së paku banorë mbi 65 vjeç, 1.5 për qind. Sipas parashikimeve të Kombeve të Bashkuara, në vitin 2100 pritet të jetë Çadi me 9.6 për qind. /rel



MSh-ja nënshkruan kontratë për përcaktimin e hartave zonale për institucionet shëndetësore

Ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar kontratë për përcaktimin e hartave zonale për institucionet shëndetësore, një hap i rëndësishëm për kompletimin e Sistemit Informativ Shëndetësor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar kontratë për "Krijimin e Zonimit në Kujdesin Parësor Shëndetësor" e cila përcakton hartën zonale për institucionet shëndetësore, koordinata të sakta gjeohapësinore, me qëllim që qytetarët të kenë qasje më të lehtë në institucionet shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH). Kjo do të mundësojë që në të ardhmen planifikimi, administrimi dhe shpërndarja e burimeve të bëhet në bazë të

zonës dhe nevojave për shërbime ndaj qytetarëve.

Fushëveprimi i projektit "Krijimi i Zonimit në Kujdesin Parësor Shëndetësor" përfshin fillimisht katër komuna (Lipjan, Prizren, Istog dhe Prishtinë), me nga pesë Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF). Pas pilotimit do të vlerësohen rezultatet e projektit në mënyrë që të gjeturat pozitive të aplikohen në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

Rezultatet nga të dhënat e grumbulluara nga ky pilot-projekt do të mundësojnë planifikimin e duhur për shtrirjen në nivel të përgjithshëm, zonimin



e KPSH-së që është një prej hapave më të rëndësishëm në reformën për shëndetësinë, në kuadër të Sistemit Informativ

Shëndetësor (SISH).

Gjithashtu, në fazën finale është edhe studimi i fizibilitetit për SISH, ndërsa të gjeturat do të

analizohen për ta krijuar sistemin e integruar të informimit shëndetësor për të gjithë qytetarët.

Operacioni "Shpërndarësi 3", policia sekuestron drogë, vetura, para dhe arreston katër persona në Gjilan



GJILAN, 6 QERSHOR - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka konfiskuar një sasi të substancave narkotike në rajonin e Gjilanit si dhe ka arrestuar katër persona. Në njoftim thuhet se hetuesit policorë nga Njësia e Gjilanit e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve (DHTN), në bashkëpunim me Njësien e DHTN Prishtinë dhe njësi të tjera policore (NjSO e K9), kanë zbatuar një plan operativ të koduar 'Shpërndarësi 3'. "Operacioni policor është hartuar dhe zbatuar me qëllim të luftimit të trafikimit të narkotikëve në rajonin e Gjilanit. Kështu, policia, në koordinim me organet e drejtësisë, ka kryer kontrole në tri lokacione. Lokacionet e kontrolluara janë pronë e të

dyshuarve: S. L., (mashkull kosovar, viti i lindjes 1981), R. R., (mashkull kosovar, viti i lindjes 1989), A. R., (mashkull kosovar, viti i lindjes 1995) dhe K. L., (mashkull kosovar, viti i lindjes 1994)", thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës. Gjatë kontrollit policia ka sekuestruar: 100.2 gramë substancë që dyshohet të jetë kokainë, dy vetura, 2 270 euro dhe 30 franga zvicerane. Ndaj të dyshuarve është iniciuar rasti 'blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge'. Të dyshuarit janë intervistuar dhe me aktvendim nga prokuroria janë dërguar në mbajtje deri në 48 orë.

KFOR-i dhe serbët "shtensionojnë" situatën në Leposaviq, i matin forcat në tërheqjen e litarit

LEPOSAVIQ, 6 QERSHOR - Edhe të martën kanë vazhduar protestat në tri komunat në veri të Kosovës. Për dallim nga ditët e mëparshme, këtë herë është vërejtur numër më i vogël i protestuesve. Serbët lokalë në Leposaviq kanë vendosur që në kuadër të protestave të përfshijnë edhe disa aktivitete sportive.

Në kuadër të kësaj të martën ushtarët amerikanë të KFOR-it dhe qytetarë serbë kanë garuar në "tërheqje të litarit". Lojërë kishin nisur një ditë më parë, ndërsa të martën serbëve iu bashkuan edhe ushtarët që po kujdesen për objektin e komunës, që kur kanë nisur protestat në fund të majit. Këto lojërë

tradicionalisht luhen në Leposaviq për më shumë se 45 vjet, sipas medieve lokale. Që nga 26 maji 2023 serbët në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq po vazhdojnë protestën e tyre. Ata po kundërshtojnë vendosjen e kryetarëve shqiptarë të zgjedhur në objektet komunale.



Përsëritet konkursi për guvernator

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) të martën ka përsëritur konkursin për guvernator të ri i cili do të jetë i hapur deri më 21 qershor. Pas dështimit të përzgjedhjes së guvernatorit nga Kuvendi i Kosovës, procesi kthehet në pikën zero dhe BQK-ja për herë të dytë ka shpallur konkursin për këtë pozitë.

Sipas njoftimit të BQK-së, emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit. "Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të përzgjedhë një individ. Miratimi dhe emërimi për këtë

pozitë do të bëhet nga Presidenti/ja i/e Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84.27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38.2 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës", thuhet në publikimin e fundit të BQK-së, raporton "KosovaPress".

Procesi i përzgjedhjes së guvernatorit kishte ngecur në Komisionin Parlamentar për Buxhet, Punë dhe Transfere, i cili kishte kërkuar nga kryeparlamentari Glauk Konjufca që ta kthejë këtë proces në pikën zero.

Ditë më parë edhe shoqëria civile në vend është shprehur e shqetësuar me prolongimin e emërimit të guvernatorit të ri



në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK).

Për konkursin e parë deri më 16 dhjetor 2022 ka qenë afati i fundit për aplikim për të gjithë

atë që kanë synuar këtë pozitë. Fillimisht për të qenë në krye të BQK-së kishin aplikuar 11 persona, përfshirë edhe ish-guvernatorin Fehmi Mehmeti.

Përveç tij, për ta drejtuar institucionin më të lartë financiar kanë qenë në garë edhe Nexhat Kryeziu, Shkëndije Himaj, Emanuel Bajra, Mentor Nimani, Beza Halilaj, Artan Ajazaj, Valdrin Krasniqi, Mentor Geci, Genc Rraci dhe Ardi Uka. Prej tyre, për këtë pozitë u patën kualifikuar katër kandidatë: Ahmet Ismaili, Nexhat Kryeziu, Lulzim Ismajli dhe Shkëndije Himaj.

Guvernatorit Fehmi Mehmeti, i zgjedhur më 15 mars të vitit 2018, i kishte mbaruar mandati më 28 mars të vitit 2023. Ndërsa prej 29 marsit Bashkim Nurboja është emëruar ushtrues detyre i guvernatorit të BQK-së.

Pse po zvogëlohet sasia e naftës së prodhuar?

VJEN, 6 QERSHOR - Organizata e Shteteve për Eksport të Naftës (OPEC) dhe vendet aleate, përfshirë Rusinë, kanë arritur marrëveshje të re për ulje të sasisë së naftës së prodhuar. OPEC me Rusinë e formojnë grupin OPEC+ dhe zotërojnë 40 për qind të naftës së parafinuar në nivel global.

Arabia Saudite, prodhuesja më e madhe e grupit, do ta zvogëlojë më së shumti sasinë e prodhimit, prej muajit korrik, deri më 2024, me qëllim të stabilizimit të tregjeve.

Njoftimi i befasishtëm i OPEC+ edhe në prill për t'i zvogëluar sasinë e prodhimit pati ndikuar në rritje të çmimeve të naftës, dhe një fuçi naftë është shitur për 87 dollarë në ditët në vijim. Megjithatë, situata ka ndryshuar me kalimin e kohës, dhe më 5 qershor një



fuçi naftë është shitur për 78 dollarë.

Në takimin e OPEC+, më 4 qershor, përveç vendimit për

zvogëlim të sasisë së prodhimit për 3.66 milionë fuçi në ditë, grupi është pajtuar edhe për ta ulur

targetin e prodhimit për vitin 2024, duke e bërë edhe një zvogëlim të sasisë për 1.4 milion fuçi.

Në kombinim diçka e tillë nënkupton zvogëlim të prodhimit për 40.46 milionë fuçi në ditë.

Shqetësimet për një krizë të re bankare, në muajt e fundit, mund t'i kenë nxitur edhe investitorët që të shesin asete të rëndësishme, meqë çmimet e naftës në javët e fundit kanë arritur në 70 dollarë për një fuçi në krahasim me pikun prej 139 dollarëve në mars të vitit 2022.

Për çmimet e naftës ka pasur shqetësime edhe në kohën kur Shtetet e Bashkuara kanë qenë duke negociuar rritjen e tavanit të borxhit, ndonëse tani partitë atje janë marrë vesh për ta shmangur krizën. Mirëpo, një recesion global

mund të ndikojë në ulje të çmimeve.

Prodhimi i naftës së parafinuar në Shtetet e Bashkuara pritet të rritet për 5.1 për qind, në 12.53 milionë fuçi në ditë, në vitin 2023, dhe për 1.3 për qind, apo në 12.69 milionë fuçi në ditë, më 2024, sipas parashikimeve të qeverisë amerikane.

Këto shifra janë dukshëm më të larta sesa 10 milionë fuçi naftë në ditë, sa prodhon ShBA-ja prej vitit 2018. Ndërkohë, Arabia Saudite ka thënë se do ta ulë prodhimin nga 10 milionë fuçi në ditë deri në maj, në 9 milionë fuçi në ditë prej korrikut. Rusia, eksportuesja e tretë më e madhe e naftës në botë, synon prodhim prej 9.5 milionë fuçive naftë në ditë deri në fund të vitit, ndërsa për vitin e ardhshëm e synon shifrën prej 9.3 milionë fuçi naftë në ditë.

Raporti financiar për buxhetin e 2022-s, evidentohet zvogëlimi i faturave të papaguara

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, kryesuar nga kryetari Armend Muja, ka shqyrtuar raportin vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Raportin vjetor financiar për buxhet e prezantoi para anëtarëve të Komisionit ministri i Financave, Hekuran Murati. Ai ka thënë se me shpenzimet dhe bilancin që është bërë, Qeveria e Kosovës ka arritur përparim, duke ngritur si shqetësim detyrimet kontingjente, ku vetëm për Këshillin Gjyqësor të Kosovës janë detyruar të paguajnë 77 milionë euro. "Në vitin që shkoi është evidentuar zvogëlimi i faturave të papaguara, ndërsa përveç Këshillit Gjyqësor që ka rritje të detyrimeve,

shqetësuese mbetet edhe te Fondi për Sigurime Shëndetësore, ku nga një auditim që është bërë dhe një verifikim që po bëhet tani, ka dalë që ka pasur shumë zotime pa mbulesë nga ana e Fondit nëpër vite dhe që rezultojnë në obligime më të larta", ka thënë ministri Murati.

Ai me këtë rast ka përmendur si përparim edhe reduktimin e numrit të të punësuarve në shërbimin civil në nivel qendror dhe lokal. Pas raportimit, anëtarët e Komisionit shtruan një sërë pyetjesh që kanë të bëjnë me shpenzimet kapitale, investimet, subvencionet dhe realizimin e projekteve të premtuara nga ana e qeverisë. Pas diskutimeve, kryetari Muja ka thënë se në lidhje me këtë



temë do të dërgojnë edhe pyetje shtesë dhe raporti vjetor financiar për buxhetin e

Republikës së Kosovës do të hidhet në votim pas marrjes së raportit nga ana e Komisionit

për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Deri 3000 vite më parë ishin një super-fuqi, çfarë ndodhi me "Popujt e Detit"?



Që në fillimet e njerëzimit, qytetërimet janë shfaqur dhe zhdukur, duke na lënë pas artefakte, histori dhe legjenda misterioze. Popujt e Detit janë një shembull veçanërisht intrigues i kulturave të zhdukura, të cilët lanë një gjurmë të pashlyeshme në botën tonë moderne.

Popujt e Detit ishin një konfederatë detarësh që udhëtuan në të gjithë rajonet e Mesdheut dhe Levantit gjatë shekullit XIII Para Krishtit. Deri më sot, ne ende nuk e dimë saktësisht pse u zhdukën aq papritur. Por dimë është se trashëgimia e tyre vazhdon në gjuhë, fe, mitologji dhe letërsi. Por kush ishin Popujt e Detit dhe nga erdhën ata? Ndonëse origjina e tyre mbetet e panjohur, shumë studiues besojnë se ata erdhën nga pjesë të ndryshme të Egjeut, Anadollit dhe Levantit. Popujt e Detit janë më të njohur për bastisjet e tyre në shkallë të gjerë në qytetet dhe vendbanimet bregdetare, që shpesh shkaktuan shkatërrime të shumta.

Dëshmitë arkeologjike, sugjerojnë se ata përdornin teknika të avancuara të ndërtimit të anijeve, si dhe armatime që u dhanë mundësinë të kryenin sulme të suksesshme. Ka të ngjarë që faktorët socialë apo ekonomikë si mbipopullimi ose mungesa e burimeve në vendlindjet e tyre, t'i ketë nxitur të kërkojnë mundësi të reja gjetkë.

Popujt e Detit kishin qasje tek armë të fuqishme që u dhanë atyre një avantazh ndaj qytetërimeve të tjera në atë kohë, duke i lejuar ata të krijojnë rrjete tregtare në të gjithë Evropën, Afrikën dhe Azinë e Vogël. Kjo gjë i dha mundësinë të bëheshin një fuqi detare me ndikim gjatë kësaj periudhe të historisë.

Po pse u zhdukën? Teoritë janë të shumta, por ajo më e gjithë-pranuara është se u shfarosën nga një kombinim i armëve, sëmundjeve dhe fatkeqësive natyrore. Harqet e përbëra mendohet se kanë qenë arma kryesore e përdorur kundër tyre.

Ky lloj harku përbëhej nga copa të shumta druri dhe brirë kafshësh, duke lejuar rritjen e fuqisë dhe saktësisë në krahasim me harqet tradicionale. Ka të ngjarë që këto armë të jenë përdorur nga armiqtë ose rivalët e Popujve të Detit për t'i larguar ata nga vendbanimet bregdetare.

Një teori tjetër sugjeron se Popujt e Detit, ishin veçanërisht të prekshëm ndaj sëmundjeve të caktuara për shkak të mungesës së imunitetit. Si një popull detar, ka të ngjarë që ata të kenë pasur pak kontakt me qytetërimet e tjera, pra nuk kanë krijuar rezistencë ndaj sëmundjeve të tilla si lija ose gripi që ishin shumë të përhapura në atë kohë.

Së fundi, disa studiues kanë argumentuar se fatkeqësitë natyrore si thatësitat ose përmbytjet, mund të kenë luajtur një rol në zhdukjen e tyre. Ndërsa nuk ka asnjë provë konkrete për të mbështetur këtë pretendim, është sugjeruar se moti ekstrem mund të ketë shkaktuar zi buke

ose ndërprerje të rrjeteve tregtare, duke çuar në vështirësi ekonomike për shumë prej vendbanimeve të tyre.

Pavarësisht nga të gjitha këto teori, nuk ka ende një konsensus të qartë se çfarë e shkaktoi përfundimisht rënien e tyre, një mister që mbetet ende sot i pazgjidhur. Megjithatë ajo që ne dimë, është se trashëgimia e tyre jeton në kulturën moderne përmes mitologjisë, letërsisë, gjuhës dhe fesë, një kujtesë e një qytetërimi të lashtë që dikur lulëzoi në këto ujëra, por që tani shtrihet i "fjetur" nën thellësitë e tij.

Përveç objekteve fizike, qytetërimet e lashta ofrojnë rrëfime të shkruara të pranisë së Popujve të Detit në zonë. Të dhënat nga Egjipti, Asiria dhe perandoritë e tjera në rajon i përshkruajnë ata si luftëtarë të fortë detarë, të cilët i kishin frikë për aftësitë e tyre bastisëse.


Kjo mbështetet më tej nga veprat e lashta të artit që përshkruajnë betejat mes tyre dhe forcave

kundërshtarë. Teoritë e asimilimit, gjithashtu sugjerojnë se disa elementë të kulturës së popujve të detit mund të ekzistojnë ende sot. Emra të ngjashëm të përdorur nga kulturat afër dhe larg vendbanimeve të tyre origjinale, tregojnë se me kalimin e kohës shumë aspekte të gjuhës u adoptuan në dialekte të tjera.

Besimet fetare të përbashkëta mes kulturave anembanë Evropës, mund të jenë gjithashtu një dëshmi e ndikimit të tyre në kulturën moderne. Tipare gjuhësore si strukturat gramatikore ose zhvendosjet fonetike, besohet se janë adoptuar prej tyre nga qytetërimet e ndryshme gjatë historisë.

Së fundi, disa elementë kulturorë nga Popujt e Detit kanë qëndruar gjatë gjithë kohës, si praktikat rituale ose instrumentet muzikore tradicionale, të cilat kanë një ngjashmëri të habitshme me ato të përdorura gjatë kësaj periudhe të historisë. / history of yesterday - bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Infantino uron Ballkanin për titullin e kampionit

SUHAREKË, 6 QERSHOR - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, përmes një telegrami drejtuar kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, e ka uruar FC Ballkanin për kurorëzimin me titull të kampionit për edicionin 2022/23 në Albi Mall Superligën e Kosovës. “Me kënaqësi të madhe e përgëzoj

FC Ballkanin për kurorëzimin me titullin e kampionit për sezonin 2022/23 në Kosovë. Ky titull nuk do të mund të arrihej pa punën e palodhur, pasionin dhe përkushtimin e gjithë ekipit, andaj të gjithë në këtë klub duhet të jenë shumë krenarë. Ju lutemi dërgoni urimet e mia për të gjithë të përfshirët në këtë arritje të

madhe! Në emër të gjithë komunitetit të futbollit, shfrytëzoj rastin t’ju falënderoj ju dhe Federatën tuaj për kontributin e dhënë në zhvillimin dhe prosperitetin e futbollit në Kosovë dhe në Evropë”, thuhet në urimin e presidentit të FIFA-s, Gianni Infantino, drejtuar të parit të FFK-së, Agim Ademi.



Sokoli për të ardhmen: Po pres të takohem me drejtuesit e Malishevës



MALISHEVË, 6 QERSHOR - Nën drejtimin e trajnerit Bylbyl Sokoli, Malisheva arrit ta sigurojë qëndrimin në Superligën e Kosovës, edhe pse ai mori drejtimin e skuadrës në javët e fundit të kampionatit. Por, përkundër kësaj, ai ende nuk e di nëse do të jetë në krye të kësaj skuadre edhe në sezonin e ardhshëm. Duke folur për “KosovaPress”, Sokoli ka thënë se është në pritje të ftesës së

drejtuesve të Malishevës për të diskutuar për të ardhmen e tij si dhe për analizën e këtij kampionati dhe planeve për sezonin e ardhshëm. “Unë ende jam nën kontratë me Malishevën, e kam datën e caktuar kur më skadon kontrata. Ende nuk jemi ulur për ta analizuar kampionatin sepse në çdo përfundim të kampionatit bëhet një analizë e punës që është bërë ai i kemi arritur synimet, ku

ishim të suksesshëm e ku jo në mënyrë që kampionatet e ardhshme të jenë më të suksesshme për ekipin. Pres që dikush nga klubi të ftojë shtabin teknik që ta analizojë kampionatin. Deri më tani ende nuk ka ndodhur dhe pastaj do të vendosim se çfarë do të ndodhë më tutje”, ka thënë Sokoli. Në fund të kampionatit Malisheva u rendit në vendin e gjashtë me 46 pikë.

SHKURT

KF Ferizaj ndan rrugët me trajnerin Panadiq

Skuadra e Ferizajt ka njoftuar se ka ndarë rrugët me trajnerin kroat Andrej Panadiq dhe zëvendësin e tij Nikola Boroë. “Andrej ishte fjalëpakë e punë shumë. Një mentalitet i futbollit kroat, bazuar në kërkesën kryesore të tij, përgjegjësi nga secili lojtar në fushën e lojës. E mori ekipin në një gjendje të vështirë, kur pakkush mund të besonte se do ta kapnim barazhin. Pavarësisht që misioni nuk përfundoi me sukses, Andrej Panadiq do të mbetet pjesë e rëndësishme e historikut të klubit tonë”, thuhet në njoftimin e Ferizajt.

Devoe Joseph nënshkruan me Sigal Prishtinën

KB Sigal Prishtina është përforcuar me basketbollistin Devoe Joseph, i cili ka një përvojë të madhe në Evropë. “Brendi më i madh sportiv shqiptar ju njofton se është finalizuar transferimi i shuterit kanadez, me përvojë të madhe në Evropë, së fundmi edhe në Kosovë, Devoe Joseph”, thuhet në njoftimin e Prishtinës.

33-vjeçari ka luajtur në skuadra elitare të shteteve si Turqi, Poloni, Ukrainë, Spanjë, Francë, Mal i Zi, Greqi, Rumania dhe Finlandë. Ai, po ashtu, ka luajtur në ABA Ligë dhe EuroCup me Budućnostin.

Blakaj largohet nga Istogu, shkon në Gjermani

Futbollisti i njohur Malsor Blakaj do të largohet nga skuadra e Istogut pas shumë vitesh. Lajmin e ka konfirmuar vetë klubi nga Liga e Parë, derisa ka njoftuar se Blakaj do të vazhdojë jetën dhe karrierën në Gjermani. “Pas shumë vitesh të kaluara në Istog që nga viti 2012, Malsor Blakaj nuk është më pjesë e klubit tonë. Malsori karrierën dhe jetën do ta vazhdojë në Gjermani. Andaj FC Istogu e falënderon shumë për kontributin e pashoq. Faleminderit ‘Coli!’ Të priftë e mbara!”, ka njoftuar skuadra e Istogut.

Mazrekaj konfirmon largimin nga Laçi

Futbollisti Mentor Mazrekaj edhe zyrtarisht është larguar nga skuadra e Laçit. Anëtori i njohur e ka falënderuar presidentin e klubit dhe ish-

trajnerin Duro për mundësinë e dhënë që t’i rikthehet futbollit aktiv. “Nëpërmjet këtij postimi që nga sot nuk jam më pjesë e KF

Laçi. Falënderime të veçanta për presidentin Pashk Laska dhe prof. Shpëtim Duro që mundësuan rikthimin tim në futbollin aktiv. Kanë qenë tri

vjet të mrekullueshme me rezultate historike si në kampionatin shqiptarë ashtu edhe në arenën ndërkombëtare me kalimin e

shumë fazave. Falënderime për të gjithë tifozët që na përkrahen pavarësisht prej rezultateve!”, ka shkruar Mazrekaj.

Benzema: Nuk do ta harroj kurrë Realin

MADRID, 6 QERSHOR - Sulmuesi francez Karim Benzema i ka thënë lamtumirë Real Madridit pas 14 sezoneve në një ceremoni të organizuar të martën në ambientet e klubit. Sulmuesi francez ditë më parë i befasoi të

gjithë kur konfirmoi largimin nga "Los Blancos". Megjithatë, ai shpjegoi lamtumirën e tij befasuese, e cila kapi klubin dhe tifozët në befas, pasi mori një vendim me familjen e tij. "Doja ta përfundoj karrierën në Real

Madrid, por ndonjëherë jeta të jep një shans tjetër. Është një vendim shumë i vështirë që e kam marrë me familjen time, por nuk do ta harroj kurrë Real Madridin", ka thënë fillimisht Benzema në ceremoninë e

lamtumirës. Ndryshe, Benzema është lojtari i pestë me më shumë ndeshje për Real Madridin, pasi ka bërë 647 paraqitje dhe është golashënuesi i dytë i të gjitha kohëve për klubin me 353 gola.



Atdhe Nuhiu emërohet trajner i Shkëndijës

TETOVË, 6 QERSHOR - Kampion me Shkëndijën në vitin 2011 dhe fitues i kampionatit dhe Kupës si trajner me Dritën e Gjilanit, Ardian Nuhiu i besohet bankina e "kuqezinjve". Kryesia dhe tekniku 44-vjeçar kanë firmosur kontratë dyvjeçare, me çka Nuhiu edhe zyrtarisht fillon punën trajner i Shkëndijës. "Ndihem shumë mirë që jam këtu. Nëse si futbollist arrita që vitin e parë të fitojmë titull, atëherë edhe projekti të cilin e kemi shpalosur këto ditë që kemi biseduar me drejtuesit ka qenë realisht bindës. Personalisht jam gati për këtë sfidë të re. Do të ndërtohet një skuadër shumë e fortë për të qenë gati në sfidat në Evropë, pastaj të futemi në kampionat", është shprehur Ardian Nuhiu pas firmosjes me kuqezinjët. Nuhiu te Shkëndija shkon pasi drejtoi disa vjet Dritën e Gjilanit me të cilën fitoi titullin kampion dhe Super Kupën, derisa kishte



paraqitje pozitive edhe në Kupat e Evropës. Stafu teknik i Shkëndijës do të kompletohet me fituesin e Kupës së vendit tonë në sezonin e shkuar me Makedonija Gj.P, Muharrem Bajrami, që nënkupton se bankina kuqezi do të ketë teknikë të rinj, por me suksese e tituj të fituar në

karrierat e tyre. Bajrami do të jetë asistent i parë i Nuhiut, ndërsa Andi Kulli do të jetë përgjegjës për videoanalizat e ndeshjeve. Ivan Jovanovski mbetet trajner kondicional, ndërsa Seladin Mustafi vazhdon trajner i portierëve.

Ferrari përplasat me Leclercun për strategjinë e garës në Spanjë

BARCELONË, 6 QERSHOR - Fundjava e kaluar ka qenë mjaft e vështirë për pilotin monogask të Ferrarit, Charles Leclerc. Të shtunën u eliminua që në sesionin e parë të provave zyrtare, duke e nisur garën nga bokset. Ndërsa të dielën e mbylli garën në vendin e 11-të, duke mos marrë asnjë pikë. Një goditje e rëndë për një pilot që synon titullin në Formula 1. Një paraqitje e dobët, kushtëzuar edhe nga një makinë që nuk është në gjendje të duelojë për kreun, duke qenë forca e katërt në kampionat. Gara e Spanjës tregoi se edhe mes pilotit e skuadrës nuk ekziston një marrëdhënie e mirë, pasi strategjia që kishin palët duket se nuk ishte e njëjta. Komunikimi në radio tregoi se piloti kërkonte goma të buta për pjesën e fundit të garës, me shpresën që ta kapte zonën e pikëve. Ndërsa skuadra vendosi t'i montonte gomat e forta. Pas garës heshtje dhe asnjë sqarim nga



palët, duke lënë të kuptosh se situata është e vështirë dhe nuk po gjendet një rrugëdalje. Risitë që Ferrari solli në Spanjë duket se funksionuan disi vetëm te makina

e Carlos Sainz, ndërsa Leclerc pati vështirësi. Një heshtje e frikshme, me skuadrën që ka deklaruar se do t'i analizojë të dhënat e marra nga të dy pilotët.

SHKURT

Suhareka bëhet edhe me një klub futbollit

Ballkani është kampion i Kosovës në futboll. Ky klub është nga Suhareka, kurse këtij qyteti i është shtuar edhe një klub tjetër, pra bëhet fjalë për "FC Suhareka". Lajmi është bërë me dije nga trajneri i njohur Ismet Munishi. "Urime FC Suhareka klubi më i ri dhe më i miri. Rrugëtim të mirë si i ka hije Suharekës", ka shkruar Munishi në "Facebook". Është raportuar se biznesmenët e kanë blerë klubin nga Prizreni, "FC A&N", të cilit do t'ia ndryshojnë emrin në "FC Suhareka".

Hazardi, afër pensionimit nga futbollit

Ylli i Kombëtares së Belgjikës, Eden Hazard, mund t'i japë fund karrierës së tij si futbollist. Raportohet se futbollisti belg është duke e shqyrtuar pensionimin nga futbollit aktiv në moshën 32-vjeçare, shkruan "Marca". Ai u largua nga Real Madridi, ku kaloi një periudhë katastrofike dhe asnjëherë nuk e arriti potencialin që e kishte sa ishte pjesë e Chelseat.

Pensionohet Burak Yilmaz

Futbollisti Burak Yilmaz i tha lamtumirë futbollit të luajtur në moshën 37-vjeçare. Sulmuesi turk, i cili në sezonin e fundit ishte pjesë e Fotuna Sittardit në Holandë, ka mbajtur një konferencë për shtyp, duke dhënë shpjegimet e nevojshme mbi vendimin e tij. "Siç e dini të gjithë, një nga lojtarët më të mëdhenj në botë (Zlatan Ibrahimović) i tha lamtumirë futbollit me lot. Edhe unë doja të thosha lamtumirë në një mënyrë tjetër, por nuk ndodhi. Sot dua të njoftoj se po i jap fund karrierës. Kam 22 vjet përvojë. Kam punuar me trajnerët më të mëdhenj të Turqisë dhe të Evropës", ka thënë Yilmaz, i cili ka veshur për 14 vjet fanellën e Kombëtares së Turqisë. Gjatë përvojës me kombëtaren është aktivizuar në 77 ndeshje dhe ka shënuar 31 gola. Ai është golashënuesi i dytë më i mirë në historinë e kombëtares turke. Rekordin e mban legjenda Hakan Sukur me 51 gola.

Zyrtare: Postecoglou, trajner i Tottenhamit

Tottenham Hotspuri e ka zyrtarizuar trajnerin e ri. Ange Postecoglou do ta drejtojë klubin nga Londra e Veriut që nga sezoni i ri. Strategu australian ka nënshkruar kontratë katërvjeçare me "Spurs"-in, kurse bëhet australian i parë që drejton një skuadër të Premierligës. Ai së fundmi e drejtoi skuadrën e Celticit, derisa ka drejtuar edhe Brisbane Roar dhe Melbourne Victory si dhe Kombëtaren e Australisë.

Pronari i Newcastle mund t'i bashkojë Messin, Ronaldon dhe Benzeman

Pronarët e skuadrës së Newcastle mund t'i blejnë klubet saudite për të cilat Cristiano Ronaldo, Lionel Messi dhe Karim Benzema mund të luajnë sezonin e ardhshëm. Fondi i Investimeve Publike të

Arabisë Saudite zotëron 80 % të aksioneve të klubit nga veriu i Anglisë dhe të hënën njoftoi blerjen e katër klubeve më të mëdha të Mbretërisë. Al-Ittihad, Al-Ahli, Al-Nassr dhe Al-Hilal janë krijuar të gjitha si

kompani të sapothemeluara me 75 % të aksioneve në pronësi të PIF. Duke qenë se kanë të njëjtët pronarë, nuk ka rregulla që ta ndalojnë Newcastle që të huazojë një nga ose të tre superijet

së bashku. Ronaldo luan për Al-Nassrin dhe Benzema sapo ka nënshkruar një kontratë dyvjeçare me Al-Ittihadin, ndërsa Messi edhe pse pëlqen një rikthim në Barcelonë, ka në tavolinë

një ofertë me pagë mbi 350 milionë paund në vit nga Al-Hilal. Megjithatë, do të ketë rezistencë të ashpër nga rivalët e Premierë Ligës nëse Newcastle përpiket të sjellë një yll global me çmim të lirë.



Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen me nenin 21, lidhur me nenin 17, dhe 25 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Ligji nr.03/L-087, dt.13.06.2008, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dt. 20.04.2012; me tej në tekst: Ligji nr.03/L-087) dhe si dhe nenit 14 të Statutit të Ndërmarrjes me nr. prot. 04/5-202, të dt. 09.03.2023, Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A., shpall:

KONKURS PËR VEND TË PUNËS

- Titulli i punës:**
1. Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit
 2. Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar i Korporatës
 3. Zyrtar i Auditimit të Brendshëm

Vendi: Prishtinë

Ndërmarrja: N.P.L Prishtina Parking Sh.A.

Afati i fundit për aplikim: 06 Korrik 2023 (e enjte) ora 16:00.

PËRSHKRIM I NDËRMARRJES

N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A. është një ndër ndërmarrjet e reja të kryeqytetit e themeluar me qëllim të ofrimit të shërbimeve të parkingut. E shtrirë në disa zona të kryeqytetit, vizioni i ndërmarrjes është zgjerimi dhe ofrimi i shërbimeve cilësore dhe efikase për të gjithë qytetarët e Prishtinës.

TITULLI PUNËS: 1. ZYRTAR KRYESOR FINANCIAR DHE I THESARIT (1 VEND PUNE)

Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit do të jetë përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të financave në N.P.L Prishtina Parking Sh.A.

Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit duhet t'i plotësojë kushtet e kualifikimit dhe të pavarësisë sipas nenit nenin 21, lidhur me nenin 17, të ligjit 03/L-087, i ndryshuar e plotësuar më vonë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
- Menaxhon dhe është përgjegjës për përpilimin e të gjitha planeve të departamentit të financave dhe thesarit, biznes planin, planin buxhetor si dhe përgatitjen e strategjisë afatmesme dhe afatgjatë;
- Menaxhon punën e përgjithshme të departamentit dhe ndihmon Kryeshefin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave si dhe harton planin e punës për departamentin e financave dhe thesarit;
- Mban përgjegjësi për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
- Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
- Përcjellë gjendjen financiare në banka dhe bashkëpunon me institucionet bankare dhe organet tjera në interes të ndërmarrjes;
- Përgatitë llogaritë periodike dhe përfundimtare;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;
- Përgjegjësi për një qeverisje efikase financiare përmes menaxhimit të sistemeve dhe kontrollit në bashkëpunim të ngushtë me auditorët;
- Të përcaktojë dhe shqyrtojë të gjitha kontrollet e brendshme financiare, përfshirë blerjet. Të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjeve të posaçme. Të kontrollojë shpenzimet e punëtorëve për të siguruar përputhje me politikën korporative dhe buxhetin para pagesës;
- Të përgatisë pasqyrat e kompanisë për auditimin e fundvitit dhe të shërbejë si ndërlydhës me auditorët;
- Përgatitë analiza dhe statistika financiare mujore dhe vjetore lidhur me departamentin e financave dhe thesarit për Bordin e Drejtorëve apo Kryeshefin Ekzekutiv;
- Mbikqyrë hartimin e pasqyrave financiare që kërkohen nga legjislati përkatës lidhur me raportet financiare dhe taksat;
- Mban një pasqyrë për nevojat për trajnime dhe siguron që stafi të ketë kualifikimin dhe trajnimet e duhura, organizon trajnimet e nevojshme;
- Merr masa disiplinore ndaj punëtorëve që kanë performancë të dobët në përmbushjen e detyrave të punës në bashkëpunim me burimet njerëzore dhe udhëheqësit e divizioneve;
- Kryen punë të tjera që kërkohen nga Bordi i Drejtorëve dhe që janë të nevojshme për funksionim efektiv të financave të N.P.L Prishtina Parking Sh.A;
- ZKFTH i raporton Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve;

Kushtet për Aplikim të Kandidatit

- Diplomë universitare në Fakultetin Ekonomik ose të ngjashme;
- Të posedojë përvojë profesionale së paku pesë (5) vite në nivel të lartë menaxherial nga fusha e financave dhe kontabilitetit;
- Posedimi i çertifikimit në kontabilitet është përparësi;

- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe 17.2 dhe 17.3 të Ligjit nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe plotësim ndryshimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 04/L-111 neni 13;
- Të ketë shkathtësi kompjuterike posaçërisht mbi sistemet e avancuara në fushën e financave/kontabilitetit;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- Të ketë aftësi në të shkruar dhe komunikim;
- Preferohet njohja e gjuhës angleze;
- Aftësi organizative, koordinuese dhe ndërpersonale;

Performanca e zyrtarit do të vlerësohet nga Bordi i Drejtorëve në mënyrë vazhdueshme.

TITULLI PUNËS: KËSHILLTARI PËRGJITHSHËM/SEKRETARI I KORPORATËS (1 VEND PUNE)

Këshilltari i Përgjithshëm është zyrtar i kompanisë, bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087) dhe është përgjegjës për përfaqësimin dhe mbrojtjen ligjore të Kompanisë.

Këshilltar i përgjithshëm/Sekretari i Korporatës duhet t'i plotësojë kushtet e kualifikimit dhe të pavarësisë sipas nenit nenin 21, lidhur me nenin 17, të ligjit 03/L-087, i ndryshuar e plotësuar më vonë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të sigurojë që kompania është duke operuar gjithnjë në pajtim me ligjin. Për ta arritur këtë objektivë, ai kërkohet që të bëjë analiza dhe të këshillojë Menaxhmentin dhe Bordin e Drejtorëve të N.P.L "Prishtina Parking" Sh.A. lidhur me çështjet ligjore, duke përfshirë, ndër të tjera, kontratat komerciale, punësimin, qeverisjen e korporatës, tatimin, pensionet, bankat & financat, rregulloren dhe politikat mjedisore, dhe për këtë qëllim të parashohë aktivitetet e Drejtorit të Zyrës Ligjore të kompanisë;
- Të sigurojë përcjelljen e procedurave nga Bordi, ku bëjnë pjesë organizmi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe në bashkëpunim me Kryesuesin e Bordit bën përgatitjen dhe shpërndarjen e rendit të ditës;
- Të kryejë rolin dhe detyrat e sekretarit të korporatës, duke përfshirë mbajtjen e regjistrit të aksionarëve dhe drejtorëve, mbajtjen e të gjitha dosjeve të nevojshme, publikimeve dhe/ose shpalosjeve për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë; dhe përgatitjen e dokumenteve për takime të Bordit të Drejtorëve, në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv, dhe mban procesverbalin e takimeve;
- Të ketë integritet, etikë dhe ndershmëri profesionale;
- Të bëjë sigurimin e komunikimit të mirë të informatave brenda Bordit, Komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe Menaxhereve të lartë të ndërmarrjes;
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit të ndërmarrjes duhet të jenë në dispozicion të të gjithë Drejtorëve të Bordit dhe duhet të sigurojë që ato përputhen me procedurat e Bordit;
- Mirëmban regjistrat e të dhënave të ndërmarrjes;
- Përcjellë ndryshimet ligjore, që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe Menaxhmentin e ndërmarrjes për ndryshimet si dhe përgatitë udhëzime të nevojshme për Menaxhmentin në ndërmarrje;
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse, siç mund të kërkohet me ligjin për ndërmarrjet publike apo statutin e ndërmarrjes;
- Koordinon me KE-në përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Merret me çështje tjera të qeverisjes së ndërmarrjes sipas nevojës;
- Njohuri e mirë e sistemit ligjor dhe ligjeve të Kosovës, veçanërisht mbi ligjin për ndërmarrjet publike dhe ligjin për shoqëritë tregtare në Kosovë;
- Të kryejë detyra të tjera ashtu siç përcaktohen, ose si i parasheh përmes dokumenteve korporative të kompanisë ose ligjet e Kosovës;
- Kryen punë të tjera që kërkohen nga Bordi dhe që janë të nevojshme për funksionim efektiv të tij;
- Sekretari i Korporatës i raporton Bordit të Drejtorëve;

Kushtet për Aplikim të Kandidatit

- Kandidati duhet të ketë diplomë nga Fakulteti Juridik (Jurist i diplomuar ose Master në shkencën Juridike);
- Kandidati duhet të ketë së paku 5 vite përvojë punë profesionale, në nivel të lartë menaxherial;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe sipas nenit 17.2 dhe 17.3 të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
- Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- Të ketë aftësi në të shkruar dhe komunikim;
- Të ketë përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;

Performanca e zyrtarit do të vlerësohet nga Bordi i Drejtorëve në mënyrë vazhdueshme.

TITULLI PUNËS: ZYRTAR I AUDITIMIT TË BRENDSHËM (1 VEND PUNE)

Detyrat dhe Përgjegjësitë

- Të planifikojë, organizojë dhe mbikëqyrë punën e Zyrës së Auditit të Brendshëm, duke përfshirë planifikimin, hartimin dhe menaxhimin e programit për auditim, organizimin dhe delegimin e punëve dhe përgatitjen e resurseve të nevojshme;
- Të hartojë Politikën e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me Misionin e Auditimit të Brendshëm dhe elementët e detyrueshëm të Kuadrit të Praktikave Profesionale Ndërkombëtare (Parimet Thelbësore të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Kodit të Etikës, Standardeve dhe Përkufizimit të Auditimit të Brendshëm). Auditori i Brendshëm duhet të rishikojë periodikisht statutin e auditimit të brendshëm dhe ta paraqesë atë për miratim të Komisioni I Auditimit;

- Të hartoj dhe propozoj planin strategjik dhe vjetor të Auditimit të Brendshëm të N.P.L Prishtina Parking Sh.A për shqyrtim dhe miratim nga Komisioni i Auditimit;
- Ti raportoj Komitetit të Auditimit, përkritazi me politikën, programet dhe aktivitetet e zyrës;
- Të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme (duke përfshirë ato financiare), si dhe të raportoj te Komisioni i Auditimit;
- Të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga N.P.L Prishtina Parking Sh.A të të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë;
- Të sugjeroj procedura të sigurimit të kualitetit dhe të verifikoj zbatimin e tyre;
- Në bashkëpunim me Zyrën Ligjore dhe në koordinim me Komisionin e Auditimit, të sugjeroj masa dhe veprime konkrete për të adresuar shkeljet e identifikuarra Ligjore tek organet e zbatimit të rendit në Republikën e Kosovës;
- Të kryejë një vlerësim të pavarur të efikasitetit të politikave, procedurave dhe standardeve nëpërmes të cilave bëhet menaxhimi i resurseve financiare, fizike dhe informative;
- Të koordinoj kornizat e auditimit me auditorët e jashtëm;

Kushtet për Aplikim të Kandidatit

- Të ketë diplomë universitare në ekonomi, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo juridik;
- të jetë Auditor i Brendshëm i Certifikuar;
- Kandidati duhet të ketë së paku 5 vite përvojë punë profesionale, në nivel të lartë menaxherial;
- Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe sipas nenit 17.2 dhe 17.3 të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
- Të posedoj njohuri të punës me kompjuter;
- Të ketë aftësi për të interpretuar dhe zbatuar Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar;
- Të posedojë aftësi për kryerjen e një game të gjerë të aktiviteteve, përfshirë këtu vlerësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm, analizën e informacioneve financiare dhe jo-financiare, kontrollimin e aktiviteteve operacionale, zbulimin e gabimeve të mundshme brenda entitetit dhe gjithashtu ofrimin e sugjerimeve të nevojshme për përmirësime;
- Të ketë pavarësi dhe nivel të lartë të integritetit përgjatë aktiviteteve në korporatë;
- Të ketë integritet profesional për të kryer një vlerësim të pavarur të efikasitetit të politikave, procedurave dhe standardeve përmes të cilave bëhet menaxhimi i resurseve financiare, fizike dhe informative;
- Të ketë aftësi në të shkruar dhe komunikim;

Paga dhe kushtet e tjera për këto vende pune, do të përcaktohen në bazë të Nenit 22 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike në Republikën e Kosovës.

Aplikacionet duhet të dërgohen te shkruara në njërin prej gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës.

Forma e Aplikacionit si dhe Deklaratës nën Betim mund të merren online në <https://prishtinaparking.net>

Dokumentacioni i kërkuar

- Aplikacionin për punësim, i cili mund të merret në faqen e N.P.L Prishtina Parking Sh.A (e nënshkruar);
- CV e detajuar e kandidatit;
- Letër motivuese;
- Dëshmitë e shkollimit dhe kualifikimet e kërkuara (diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nistrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHTI-t);
- Dëshmitë e përvojës së punës dhe pasqyra e trustit pensional;
- Referencat dhe certifikatat tjera profesionale;
- Deklaratën nën Betim e cila merret në faqen e N.P.L Prishtina Parking Sh.A (e nënshkruar);
- Certifikatën nga gjykata kompetente që kandidati nuk është nën hetime jo me vjetër se 6 muaj;
- Kopjen e letërnjoftimit;

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në [zarf të mbyllur](#) në këtë adresë:

Zyret Qendrore të N.P.L. "Prishtina Parking" Sh.A

Rr. "Luan Haradinaj", p.n.

Pallati i Rinisë, 10000, Prishtinë, Kosovë.

-Kandidatët të cilët konkurojnë duhet ta shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën.

-Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.

-Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Konkursi është i hapur nga data: 07 Qershor 2023 – 06 Korrik 2023, ora 16:00.



Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



U skladu s funkcijama i ovlastima predviđenim člankom 21., povezanim s člankom 17. i 25. Zakona o javnim poduzećima Zakon br. 03/L-087 od 13. lipnja 2008., izmijenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-111 dt. 20.04.2012.; dalje u tekstu: Zakon br.03/L-087) te kao i članak 14. Statuta Društva pod br. prot. 04/5-202, od 09.03.2023., Upravni odbor lokalnog javnog poduzeća "Prishtina Parking" S.A., objavljuje:

NATJEČAJ ZA POSAO

- Naziv posla:**
1. Glavni službenik za financije i riznicu
 2. Glavni savjetnik/Korporacijski tajnik
 3. Službenik unutarnje revizije

Mjesto: Priština

Tvrtka: N.P.L Prishtina Parking Sh.A.

Rok za prijavu: 06. srpnja 2023. (četvrtak) do 16:00 sati.

OPIS TVRTKE

N.P.L. "Prishtina Parking" dd. jedno je od novih poduzeća u glavnom gradu osnovano za pružanje usluga parkiranja. Rasprostranjena na nekoliko područja glavnog grada, vizija tvrtke je proširiti se i pružiti kvalitetne i učinkovite usluge svim građanima Prištine.

NAZIV RADNOG MIJESTA: 1. GLAVNI REFERENT ZA FINACIJU I RIZNICU (1 RADNO MIJESTO)

Glavni službenik za financije i riznicu bit će odgovoran za cjelokupno upravljanje financijama u N.P.L Prishtina Parking Sh.A.

Glavni službenik za financije i riznicu mora ispunjavati uvjete kvalifikacije i neovisnosti prema članku 21., koji se odnosi na članak 17. Zakona 03/L-087, koji je kasnije izmijenjen i dopunjen.

Dužnosti i odgovornosti:

- Odgovoran je za provedbu svih finansijskih odredbi i računovodstvenih standarda, važećih zakona na Kosovu koji reguliraju finansijska pitanja i normativnih akata poduzeća;
- Vodi i odgovoran je za izradu svih planova odjela financija i riznice, poslovnog plana, plana proračuna, kao i izradu srednjoročne i dugoročne strategije;
- Upravlja općim radom odjela i pomaže glavnom ravnatelju u postavljanju ciljeva i izradi plana rada za ispunjenje tih ciljeva, kao i izradi plana rada odjela financija i riznice;
- Odgovoran je za plaćanje finansijskih obveza sukladno finansijskim propisima;
- Vodi točnu evidenciju i dokumentaciju o ulaganjima i plaćanjima tvrtke;
- prosljeđuje finansijsko stanje bankama i surađuje s bankarskim institucijama i drugim tijelima u interesu poduzeća;
- Izrada periodičnih i završnih računa;
- Odgovoran je za pripremu bankovnih prijenosa ili plaćanja s popratnom dokumentacijom i uvjerava EK da je plaćanje uredno;
- Odgovornost za učinkovito finansijsko upravljanje kroz sustav upravljanja i kontrole u bliskoj suradnji s revizorima;
- Definirati i pregledati sve interne finansijske kontrole, uključujući nabavu. Pratite račune prema dobavljačima i koordinirajte plaćanje računa i posebnih kupnji. Kontrolirajte troškove zaposlenika kako biste osigurali usklađenost s korporativnom politikom i proračunom prije plaćanja;
- Priprema izvješća tvrtke za reviziju na kraju godine i služi kao veza s revizorima;
- Priprema mjesečne i godišnje finansijske analize i statistike vezane uz odjel financija i riznice za Upravni odbor ili Glavnog izvršnog direktora;
- Nadzire pripremu finansijskih izvještaja koje zahtijeva relevantno zakonodavstvo u vezi s finansijskim izvještajima i porezima;
- Vodi pregled potreba za obukom i osigurava odgovarajuću osposobljenost i obuku osoblja, organizira potrebnu obuku;
- Poduzima stegovne mjere prema radnicima koji ne ispunjavaju radne zadatke u suradnji s kadrovicima i voditeljima sektora;
- Obavlja druge zadatke koje zahtijeva Upravni odbor i koji su neophodni za učinkovito poslovanje financija N.P.L Prishtina Parking Sh.A;
- ZKFTH odgovara glavnom izvršnom direktoru i Upravnom odboru;

Zahtjevi za prijavu kandidata

- VSS Ekonomski fakultet ili sl.;
- Imati najmanje pet (5) godina profesionalnog iskustva na visokoj rukovodećoj razini iz područja financija i računovodstva;
- Posjedovanje certifikata iz računovodstva je prednost;
- Da ispunjava uvjete kvalifikacije prema članku 17.1. kao i 17.2 i 17.3 Zakona br. 03/L-087 javnih poduzeća i izmjene i dopune Zakona o javnim poduzećima br. 04/L-111 članak 13.;
- Posjedovati računalne vještine, posebno na naprednim sustavima u području finansijsko računovodstvo;
- Ovaj visoki moralni i profesionalni integritet;
- Ova sposobnost pisanja i komunikacije;

- Poželjno je poznavanje engleskog jezika;
 - Organizacijske, koordinacijske i međuljudske vještine;
- Učinak službenika kontinuirano će ocjenjivati Upravni odbor.

NAZIV POSLA: GLAVNI SAVJETNIK/KORPORACIJSKI TAJNIK (1 POSAO)

Glavni savjetnik je dužnosnik Društva, na temelju Zakona o javnim poduzećima (Zakon br. 03/L-087) i odgovoran je za pravno zastupanje i zaštitu Društva.

Glavni savjetnik/tajnik Društva mora ispunjavati uvjete kvalifikacije i neovisnosti prema članku 21., koji se odnosi na članak 17. Zakona 03/L-087, koji je kasnije izmijenjen i dopunjen.

Dužnosti i odgovornosti:

- Osigurati da tvrtka uvijek posluje u skladu sa zakonom. Kako bi postigao ovaj cilj, od njega se traži da analizira i savjetuje Upravu i Upravni odbor N.P.L "Prishtina Parking" Sh.A. u vezi s pravnim stvarima, uključujući, ali ne ograničavajući se na komercijalne ugovore, zapošljavanje, korporativno upravljanje, oporezivanje, mirovine, bankarstvo i financije, regulativu i politike zaštite okoliša, te u tu svrhu predviđaju aktivnosti direktora pravnih poslova tvrtke;
- Osigurati praćenje postupaka od strane Upravnog odbora, što uključuje organizaciju sastanaka Upravnog odbora, povjerenstava Upravnog odbora te u suradnji s predsjednikom Upravnog odbora priprema i distribuira dnevni red;
- Obavlja ulogu i dužnosti korporativnog tajnika, uključujući vođenje registra dioničara i direktora, vođenje svih potrebnih dosjea, publikacija i/ili objava za Kosovski poslovni registar; te priprema dokumentaciju za sjednice Upravnog odbora, u suradnji s glavnim izvršnim direktorom, te vodi zapisnik sa sjednica;
- Posjedovati integritet, etiku i profesionalno poštenje;
- Osigurati dobru komunikaciju informacija unutar odbora, njegovih odbora i između odbora i viših rukovoditelja poduzeća;
- Savjeti i usluge tajnika Društva moraju biti dostupni svim direktorima Uprave i moram osigurati da se pridržavaju procedura Uprave;
- Održava evidenciju podataka tvrtke;
- Pratiti zakonske promjene vezane uz poduzeće obavještavajući Upravu i Upravu poduzeća o promjenama, kao i pripremati potrebne upute za Upravu poduzeća;
- Izvršava sva arhiviranja, objave i/ili otkrivanja relevantnim tijelima, kako se može zahtijevati zakonom o javnim poduzećima ili statutom tvrtke;
- Koordinira s EK pripremu dopisa (dokumenata) za sastanke Upravnog odbora;
- Bavi se drugim pitanjima upravljanja poduzećem prema potrebi;
- Dobro poznavanje pravnog sustava i zakona Kosova, posebno zakona o javnim poduzećima i zakona o trgovačkim društvima na Kosovu;
- Za obavljanje drugih zadataka kako je definirano ili predviđeno korporativnim dokumentima tvrtke ili zakonima Kosova;
- Obavlja i druge poslove koje odredi Uprava, a koji su nužni za njezin učinkovit rad;
- Tajnik Društva odgovara Upravnom odboru;

Zahtjevi za prijavu kandidata

- Kandidat mora imati završen pravni fakultet (diplomirani pravnik ili magistar pravnih znanosti);
- Kandidat mora imati najmanje 5 godina radnog iskustva u struci, na visokoj rukovodećoj razini;
- Da ispunjava uvjete kvalifikacije prema članku 17.1. kao i prema članku 17.2 i 17.3 zakona br. 03/L-087 javnih poduzeća i izmjene i dopune zakona o javnim poduzećima br. 04/L-111 članak 13.;
- Poznavanje rada na računalu;
- Da ima visok moralni i profesionalni integritet;
- Posjedovati vještine pisanja i komunikacije;
- Imati značajno profesionalno iskustvo u području korporativnog upravljanja ili prava društava;

Učinak službenika kontinuirano će ocjenjivati Upravni odbor.

NAZIV POSLA: REFERENT INTERNE REVIZIJE (1 RADNO MESTO)**Dužnosti i odgovornosti**

- planirati, organizirati i nadzirati rad Ureda za unutarnju reviziju, uključujući planiranje, izradu i upravljanje programom revizije, organizaciju i delegiranje poslova te pripremu potrebnih resursa;
- Izraditi Politiku unutarnje revizije, u skladu s Misijom unutarnje revizije i obveznim elementima Međunarodnog okvira profesionalne prakse (Temeljna načela profesionalne prakse unutarnje revizije, Etički kodeks, Standardi i definicija interne revizije). Unutarnji revizor mora povremeno pregledati povelju unutarnje revizije i podnijeti je na odobrenje Odboru za reviziju;

- Izraditi i predložiti strateški i godišnji plan interne revizije N.P.L Prishtina Parking Sh.A na razmatranje i odobrenje od strane Odbora za reviziju;
- Izvještavate Odbor za reviziju u vezi s politikama, programima i aktivnostima ureda;
- Provjera primjerenosti i pravilnog rada internih kontrola (uključujući financijske), kao i izvještavanje Odbora za reviziju;
- Provjera prikladnosti i redovitog funkcioniranja sustava i postupaka koji imaju za cilj jamčiti provedbu svih primjenjivih zakona na Kosovu od strane N.P.L. Prishtina Parking Sh.A.;
- Predložiti postupke za osiguranje kvalitete i provjeriti njihovu provedbu;
- U suradnji sa Pravnom kancelarijom iu koordinaciji sa Komisijom za reviziju, predložiti konkretne mere i radnje za rešavanje identifikovanih povreda zakona organima za sprovođenje zakona u Republici Kosovo;
- Provesti neovisnu procjenu učinkovitosti politika, procedura i standarda putem kojih se upravlja financijskim, fizičkim i informacijskim resursima;
- Koordinirati revizijske okvire s vanjskim revizorima;

Zahtjevi za prijavu kandidata

- da ima visoku stručnu spremu ekonomije, javne uprave, javnih financija, računovodstva ili prava;
- biti ovlašten unutarnji revizor;
- Kandidat mora imati najmanje 5 godina radnog iskustva u struci, na visokoj rukovodećoj razini;
- Da ispunjava uvjete kvalifikacije prema članku 17.1. kao i prema članku 17.2 i 17.3 zakona br. 03/L-087 javnih poduzeća i izmjene i dopune zakona o javnim poduzećima br. 04/L-111 članak 13.;
- Poznavanje rada na računalu;
- Imati sposobnost tumačenja i primjene Međunarodnih standarda financijskog izvještavanja;
- Posjeduje sposobnost obavljanja širokog spektra aktivnosti, uključujući evaluaciju sustava interne kontrole, analizu financijskih i nefinancijskih informacija, kontrolu operativnih aktivnosti, otkrivanje mogućih grešaka unutar subjekta te također davanje prijedloga potrebnih za poboljšanja;
- Imati neovisnost i visoku razinu integriteta tijekom svih aktivnosti u korporaciji;
- Posjedovati profesionalni integritet za provedbu neovisne procjene učinkovitosti politika, procedura i standarda putem kojih se upravlja financijskim, fizičkim i informacijskim resursima;
- Posjedovati vještine pisanja i komunikacije;

Plata i drugi uslovi za ove poslove utvrđuju se na osnovu člana 22 Zakona o javnim preduzećima u Republici Kosovo.

Prijave se moraju poslati u pisanom obliku na jednom od službenih jezika u Republici Kosovo. Prijavni obrazac kao i Izjava pod prisegom mogu se dobiti online na <https://prishtinaparking.net>.

Potrebna dokumentacija

- Zahtjev za zapošljavanje, koji se može dobiti na web stranici N.P.L Prishtina Parking Sh.A (potpisano);
- detaljan životopis kandidata;
- Motivacijsko pismo;
- Dokazi o obrazovanju i potrebnim kvalifikacijama (diplome stečene izvan Republike Kosovo moraju biti službeno priznate/nostrificirane od strane MASHTI-ja);
- Dokaz o radnom stažu i izjava o mirovinskom osiguranju;
- Reference i druge stručne potvrde;
- Izjava pod zakletvom koja je dostupna na web stranici N.P.L Prishtina Parking Sh.A (potpisano);
- Uvjerenje nadležnog suda da kandidat nije pod istragom ne starije od 6 mjeseci;
- Presliku osobne iskaznice;

Popunjenu dokumentaciju potrebno je dostaviti u zatvorenoj koverti na adresu:

*Središnji uredi N.P.L. "Prishtina Parking" Sh.A
Sv. "Luan Haradinaj", str.
Palača mladosti, 10000, Priština, Kosovo.*

- Kandidati koji se natječu moraju unijeti točnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu.
- Na razgovor će biti pozvani samo odabrani kandidati.
- Nepotpuni dokumenti i oni koji pristignu nakon natječajnog roka neće se razmatrati.

Natječaj je otvoren od: 07. lipnja 2023. – 06. srpnja 2023. do 16:00 sati.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

